



PROCESVERBALI

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 17.09.2018, me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të KPF-së, pasi është mbledhja e parë e KPF-së pas humbjes së jetës të kuvendarit z. Astrit Thaqi, ju kisha kërkuar që ta nderojmë me një minutë heshtje. Ju faleminderit të gjithëve, ja fillojmë me mbledhje, fillimisht më lejoni që ti përshëndes, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e KFORIT, OSBE-së, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuorum për mbajtjen e mbledhje kemi, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës, që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike,**
3. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për marrjen e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510008-00268-1,**
4. **Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019,**
5. **Shqyrtimi i Propozim Buxhetit si dhe KAB-it për vitin 2019 – 2021,**
6. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka ndonjëri nga ju ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithët të pranishmit, është bërë një gabim teknik tek diskutimi imë në faqe nr.2, në vend se të shkruhet situacionin në teren, është shkruar stacionin në teren, vetëm kjo le të përmirësohet.

Kryesuesi – E qes në votim Procesverbalit nga mbledhja e kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në piklën e radhës të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës, që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike.

Afrim Oruçi - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ky propozim ka të bëjë me zonën kadatrale në qytetin e Rahovecit, pëlqimi kërkohet për pronë private, materialin që e keni para vete shkruan se kërkesa ka të bëjë me marrjen e pëlqimit për hapje të rrugës. Të nderuar kuvendar është dashur kështu ta procedojmë për arsye se rruga vetëm është e hapur dhe është publike dhe e kalueshme, këtu bëhet fjalë për ish rrugën “28 Nëntori”, tani e emërtuar “ Ibrahim Rugova”, dhe rruga tjetër që kalon ka rruga “Gëzim Hamza – Piktori”. Kemi të bëjmë me 1 ari e 15 m², pronë private, në emër të bashkë poseduesve Jalldëze, Zijajdin, Selajdin dhe Bahrije Durguti. Kjo rrugë është hapur dhe asfaltuar ka fundi i viti 2014, pronarët e kësaj parcele edhe në atë kohë kanë bërë kërkesë për kompensim, e keni kërkesën para vete që e kanë bërë në vitin 2015, po ashtu edhe në vitin 2017. Ne si pas ligjit nuk kemi të drejtë me e këmbye pronën private me atë publike, por kemi të drejtë me bë shpronësimin e

kësaj prone private. Ne jemi takuar disa herë me pronarë të kësaj parcele, ku na janë drejtuar neve me kërkesë që të iniciohet procedura për shpronësim ose në të kundërtën ata na kanë kërcënuar se do të shkojnë me procedurë gjyqësore. Ne kemi një pronë në të njëjtën rrugë, kjo pronë në atë kohë nuk është shpronësuar dhe pala në atë kohë e ka dërguar komunën në gjykatë, ku më pas pala ka fituar kontestin gjyqësorë dhe pas procedurave gjyqësore mjetet janë tërhequr pa na pyetur neve nga thesari. Prandaj ne e kemi parë të arsyeshme pasi që kjo është pronë private dhe është e drejtë e tyre që në cilën do kohë dhe rast të njëjtë ata e fitojnë kontestin në gjykatë, prandaj ne e kemi marrë vendim që ta iniciojmë këtë kërkesë për kuvend, pasi që palëve në atë kohë kur ka filluar asfaltimi i kësaj rruge, ju është thënë se mos të i pengojnë punimet, pasi që të asfaltohet kjo rrugë do të bëhet kompensimi. Të nderuar anëtar të KPF-së kërkoj nga ju që pas shqyrtimit të këtij propozimi ta përkrahni pëlqimin për fillimin e procedurave për shpronësim të kësaj prone private.

Rasim Fazliu – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, mendoj se ky zotëri është dashur me kohë të i ngulë këmbët dhe mos të i lejojë që të shtrojnë rrugën në pronë private, sepse prona ka qenë e tij. Është dashur të i thotë një herë paguani e pastaj filloni të ndërtoni rrugën, faji në një farë mënyrë është tek ky edhe pse nuk dua që ti fajësoj edhe këta të tjerë që kanë bërë një veprim të paligjshëm, sepse kanë shtruar rrugën në pronë private. I nderuari drejtor ku gjendet më sakë kjo rrugë edhe pse na tregove me emra, por me emra nuk i dimë mirë se ku gjendet kjo rrugë, dua ta di saktë ku gjendet kjo rrugë. Diçka tjetër që dua të them është se a ka buxhet komuna sepse ne gjithmonë ankohemi se nuk ka buxhet komuna, nuk është vetëm ky rast, munden të na paraqiten edhe shumë raste të tjera në të ardhmen, pra thjeshtë pyetje ime është: A ka komuna buxhet të mjaftueshëm që të hyjë këtyre procedurave për shpronësim. Sa i përket kësaj pike pronari ka të drejtë dhe ne nuk guxojmë të themi se nuk jemi për shpronësim, ne jemi gjithsesi për shpronësim të kësaj prone, por shqetësimi ynë është a ka komuna mjete për kompensim, nëse ka atëherë ne e përkrahim iniciativën e Drejtorisë së Kadastrës për shpronësim të kësaj parcele.

Flori Boshnjaku – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, në lidhje me këtë procedurë për shpronësim siç e tha edhe z. Rasim Fazliu, pala në një rast ka të drejtë edhe me gjykatë me na padit dhe do ta realizojë këtë kërkesë, por në anën tjetër pyetja ime konkrete është: Kur është ndërtuar kjo rrugë a është shpallur interesi i përgjithshëm apo jo, nëse nuk është shpallur atëherë ne nuk kemi se si të japim pëlqimin për kompensim. Pra një herë duhet që të shpallet interesi i përgjithshëm, të pajtohen palët dhe të i ofrohen kushtet, nëse nuk donë atëherë ne e shpallim interesin e përgjithshëm dhe i shikojmë pastaj procedurat tona sepse kemi të drejtë me e bë shpronësimin. Përndryshe plotësisht pajtohem me këtë kërkesë të këtij qytetari, por kolegë të nderuar nëse ne ja fillojmë me këto kompensime, atëherë do na vinë me dhjetëra dhe qindra kërkesa, sepse për çdo ditë qytetarët më pyesin se si është e mundur me bërë kompensimin sepse kjo rrugë, ky lumë ose ky kanalizim është e ndërtuar në parcelën tonë, prandaj nëse e bëjmë duhet që të bëjmë për të gjithë. Është mirë që të konsultoheni me juristë, ne jemi këtu dhe jemi pro që ti dalim në ndihmë qytetarëve.

Fehmi Cena – Do mundohem që të japë kontributin tim, edhe pse nuk e di saktësisht se si është situacioni në teren prandaj ne e kemi vështirë që të dimë saktësisht se ku gjendet kjo rrugë. Por nga ajo që ne mundemi me e pa nga materiali që e kemi para vete na dele se këta pronarë të kësaj parcele janë të gjithë të një familje, për mua një rrugë publike është nëse nuk i shërben vetëm një familje sado që ajo të jetë e gjerë. Ne e dimë që Rahoveci ka nevojë për hapje të rrugëve të reja, por nëse kjo rrugë së paku e lidhë edhe një rrugë tjetër sado që të jetë e vogël, por që kyçen edhe të tjerët, atëherë jam pro kësaj kërkesë që të kryhet ashtu siç jeni duke kërkuar. Por nëse kjo ka qenë një arë dhe disa nga vëllezërit kanë ndërtuar shtëpi banimi, ku pastaj e kanë qelë rrugën për vete, ndërsa të tjerët nuk kanë kyçje në këtë rrugë, për mua kjo nuk është kyçje publike dhe nuk e di pse komuna duhet që të ketë këtë përgjegjësi. Sidoqoftë do të doja që herrave të tjera drejtoria të na paraqes me skicë në monitor nëse ka mundësi, pra ta dimë saktësisht se ku gjendet kjo rrugë dhe me cilat rrugë tjera lidhet, sepse është problem ne të gjithë me e ditë se si është situata në teren, pastaj ne ka mundësi me ja hëngër hakun ose atyre ose komunës.

Dervish Çadraku – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, mua me të vërtet më vije shumë befasi nga materiali që na ka ardhur sot, sepse është materie e viti 2015, çka është më e rëndësishme duke ju dhënë të drejtën kolegëve paraprak, kjo nuk është e specifikuar dhe e skicuar në mënyrë që ta dimë ne se ku ndodhet kjo

parcelë, pastaj a është rrugë familjare apo rrugë publike, në kuptimin e asaj a kyçen edhe qytetarët e tjerë jashtë familjes së tyre. Por ajo që më çudit më së shumti është se si ka mundësi që shteti të bëjë një veprim të tillë, ai duhet të kërkojë nga qytetarët që mos të bëjnë shkelje të ligjit, kurse vetë shteti e ka shkelur ligjin në kuptimin e asaj se hajt se e bëjmë kollaj ne, lirona ti një herë ta rregullojmë rrugën, pastaj ne do mëremi vesh. Ndërsa është dashur të bëhet e kundërta, është dashur së pari të shpallet si interes i përgjithshëm kjo parcelë, pastaj të fillojnë procedurat e rregullta, pra tamam ashtu siç duhet të funksionoj shteti. Pra ne duhet të skuqemi para këtyre monitoruesve kur dëgjojnë se vetë shteti bënë këso shkelje, e çka duhet të bëjë qytetari pastaj, është mirë që të ndjekin procedurat ne asnjë shkresë nuk e kemi që ka bërë marrëveshje komuna me qytetarët, ndërsa krejt kjo që ne jemi duke diskutuar është në hava, ashtu siç e tha edhe z. Fehmi Cena, ka mundësi që ata të jenë familjar në mes vete dhe komuna duhet tani që të ja kompensoj tokën e tyre. Megjithatë duhet që të ja fillojmë me procedurat e rregullta, nëse është rrugë publike jo vetëm kjo por kudo që është e nevojshme ne duhet që të gjejmë mjete në mënyrë që qytetarët të kenë qarkullim të mjaftueshëm.

Afrim Oruçi – Kjo parcelë ka të bëjë me rrugë publike, fillimi i rrugës është tek parku i qytetit, vazhdon në drejtim të lokalit toska dhe del tek stacioni i autobusëve, dhe në fund lidhet me ish shkollën Iliria. Kjo rrugë publike më herët është quajtur rruga “28 Nëntori”, ndërsa tani quhet rruga Ibrahim Rugova, parcela prej 1 ari e 15m² shtrihet tek lokali konaku, një pjesë e parcelës gjendet në këtë rrugë ndërsa pjesa tjetër gjendet përmbi urë që lidhet me rrugën e Gjimnazit Xhelal Hajda – Toni, dhe dele në rrugën Gëzim Hamza – Piktori. Pra kjo parcelë e ka një pjesë të shtrirë që shkon në drejtim të stacionit të autobusëve dhe një pjesë të parcelës e ka përmbi urë që të çon tek rruga “Gëzim Hamza – Piktori”. Pra është rrugë publike me dalje dhe është interes i përgjithshëm. Kishte pyetje se a ka buxhet të mjaftueshëm, drejtorja për gjeodezi, kadastër dhe pronë i ka të paraparë për shpronësim brenda vitit afër 50,000.00 €, pra sipas kësaj mjete kemi. Po ashtu kishte pyetje se a është shpallur më parë interesi i përgjithshëm kjo rrugë, para se të filloj me u hapë kjo rrugë, kuvendi komunal ka marr vendim ku e ka shpallë interesin e përgjithshëm komplet këtë rrugë deri tek stacioni i autobusëve, sepse këtu kemi të bëjmë me 3 parcela private, dy parcelat private e kanë realizuar interesin e vetë, ka mbetur vetëm kjo parcelë që ta realizoj të drejtën e vetë. Kërkesa e palës e drejtuar në vitin 2015 është drejtuar edhe në vitin 2017, arsyeja pse e ka bërë prapë është sepse zyrtarët komunal i kanë thënë se kërkesa e citit 2015 është humbur dhe duhesh që të na ri’ procedon edhe një kërkesë tjetër. Njëjtë edhe unë sikurse ju i kam thënë palëve kur kanë qenë në takim që është dashur të i pengoni mos ta shtrojnë këtë rrugë para se të ju bëjnë kompensimin, por palët me mirëbesim dhe marrëveshje kanë lejuar, po ashtu i kam thënë se lënda duhet që të vijë në kuvend dhe pastaj kuvendi të na jepe leje për shpronësim, që i bije është e drejtë e juaja që të jepni ose të mos jepni pëlqim për shpronësim, por duhet të dini se është edhe e drejta e pronarit të kësaj parcela që të realizojë të drejtën e tijë përmes gjykatës sikurse dy pronarët e tjerë që e kanë realizuar.

Rasim Fazliu – Është shumë në rregull kjo që na shpjegoi drejtori, por sikurse të ishin këto fjalë qysh në fillim do të ishte pak më ndryshe. Ai në kërkesë e ka cekur se të drejtën e tij mundet që ta realizojë edhe përmes gjykatës, kjo është në rregull, por nuk është nevoja sepse kjo duket sikurse është duke na kërcënuar neve, sepse ne mundemi tani mos me marr vendim dhe ai le të shkon përmes gjykatës pasi po thotë ashtu, pasi ka dashur të shkojë përmes gjykatës nuk e di pse ka bërë kërkesë tek ne. Por ne e thamë më parë nëse komuna ka mbulesë buxhetore ne jemi pro kësaj kërkesë.

Fehmi Cena – Kërkoj nga drejtori që në mbledhjen e ardhshme të kuvendit skica të ketë të dhëna më shumë, edhe sot ne sikurse të kishim shënime pak më tepër, për ato rrugë që jeni duke i përmendur si rruga Ibrahim Rugova dhe ajo urë e kishim pas më të qartë. Ne nuk kërkojmë që me ngjyra të na sjellë por vetëm të kenë emra dhe të ketë vija ku dallohen rrugët, tani e kam të qartë pak dhe sipas meje nëse është ajo që mendoj unë i plotëson që të jetë rrugë publike.

Dervish Çadraku – Mendoj se duhet të ketë më shumë informata shtesë, ne që jemi këtu e kuptuam shumë gjëra, por informatat shtesë është mirë të ketë për kuvendarët e tjerë që nuk janë pjesë e KPF-së.

Kryesuesi – E qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës, që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike, që të kalojë në kuvend

për shqyrtim dhe aprovim. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytë(2) e rendit të ditës. Kalohet në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për marrjen e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510008-00268-1.

Afrim Oruçi – Propozimi ka të bëjë me zonë kadastrale në Hoçë të Madhe, me propozim të kryetarit ju është propozuar kuvendit të komunës që të merret vendimi për shpallje të interesit të përgjithshëm publik parcela 00268-1, në fshatin Hoçë e Madhe, zonë kadastrale me hapësirë prej 3 hektar e 167 ari e 7 m². Qëllimi i shpalljes së kësaj parcele me interes të përgjithshëm është ruajtja e vlerës së pronës komunale, po ashtu që të përdoret për nevojat e përgjithshëm publik, ruajtjes së pronës dhe ngritjes së vlerës. Kjo zonë gjendet tek fabrika e kartonëve tek rruga Rahovec – Suharekë, ftojë anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të këtij propozim vendimi të mbështesin për shpallje të interesit të përgjithshëm.

Florije Boshnjaku – Mendoj se është shumë mirë që të shpallet interes i përgjithshëm kjo parcelë, për arsye se duhet që të ruajmë pronën e komunës e cila është shumë me vlerë. Desha ta pyes drejtorin sepse nuk e kam të qartë, në këtë rast a duhet që të kërkohet pëlqimi i këshillit të Hoçës së Madhe, pasi që parcelat e Hoçës së Madhe janë zona të mbrojtura.

Fehmi Cena – I nderuari drejtor kjo pjesë a i takon pjesës industriale, pastaj a është nën rrugën kryesore apo mbi rrugë, pastaj a është e përfshirë në zonën industriale kjo parcelë, nëse ka mundësi disa sqarime të shkurta.

Rasim Fazliu – Pajtohem me kolegët me ato që i thanë, por paraprakisht desha të them se si zonë e mbrojtur është vetëm territori i ngushtë i fshatit, pra territori i brendshëm i fshatit. Edhe ne jemi që kjo parcelë të shpallet interes i përgjithshëm sepse kjo është mirë edhe për komunën tonë. Por unë kam një pyetje për drejtorin e gjeodezisë, mos ka qenë dikush paraprakisht i interesuar që ta shfrytëzoj për diçka këtë parcelë sepse do na lehtësonte punën, sepse ka njerëz që i nuhasin këto gjëra për qëllime të bizneseve, pra pyetje ime është mos dikush ka shprehur interes për këto çështje dhe ne tani duhet që ti ndjekim procedurat, një herë të shpallim interes të përgjithshëm në mënyrë që të vijmë deri tek realizimi i qëllimit të atij individi.

Afrim Oruçi – Sa i përket asaj se a duhet që të kërkohet pëlqimin nga Këshilli i Hoçës së Madhe, ne jemi në fazën kur nuk kemi nevojë me u konsultuar me këtë këshill edhe pse është funksional, parcela në fjalë është në pjesën e mbrojtur të zonës kadastrale Hoçë e Madhe, paraprakisht çdo investim apo ndërtim në atë pjesë duhet që të merret pëlqimi edhe nga Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe. Ne tani jemi në fazën kur duhet që të kërkohet pëlqim nga kuvendi që këtë zonë me e shpallë si zonë me interes të përgjithshëm, për momentin interesi i komunës që ta mbrojë këtë parcelë dhe ta e risë vlerën kësaj parcele, në mënyrë që në të ardhmen nëse kemi projekte të tjera të cilat kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik të komunës, atëherë mundemi që ti drejtohem edhe këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, ndërsa për momentin nuk kemi nevojë që të konsultohemi me këshill. Pastaj pyetje tjetër ishte se a i takon zonës industriale, jo i nderuar nuk i takon sepse kjo zonë është në anën e majtë të rrugës, në drejtim të Suharekës mbi rrugë, mbi fabrikën e kartonëve dhe komplet pjesa që gjendet mbi fabrikë është diku rreth 3 hektarë. A ka shpreh dikush interes për këtë parcelë para se ne me e shpallë zonë me interes të mbrojtur, i vetmi organ i cili ka shpreh interes për me e mbrojtë këtë pronë është komuna e Rahovecit, qëllimi është mbrojtja e kësaj prone si shumë prona të tjera. Ne mendojmë që brenda mandatit që shumicën e pronave komunale të cilat kanë mbetur dhe nuk janë tjetërsuar përmes gjykatave ose formave të tjera, me i shpallë zonë me interes të përgjithshëm, ku qëllimi i vetëm është mbrojtja dhe rritja e kësaj vlere. Ne para se me e shpallë këtë zonë me interes të përgjithshëm, komuna ka ide paraprake ku njëra nga zonat mundet me u shpreh si propozim në të ardhmen kur të vendoset për një hapësirë të rrafshuar, ajo mundet të përdoret për parking të auto veturave që do të konfiskohen nga merimanga, por nëse tentohet diçka të ndërtohet atëherë duhet që të marrim pëlqimin nga këshilli i Hoçës së Madhe.

Kryesuesi – Nëse nuk keni diçka të shtoni rreth kësaj pike, e qes në votim propozim vendimin e Kryetarit për marrjen e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510008-00268-1: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalohet në pikën e radhës:

4. Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam nderin që të ju japë një informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor. Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë gjithë muajit të fundit ka punuar dhe ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2018/2019. Në fillim të muajit gusht, kemi analizuar me kujdesin më të madh gjendjen e personelit mësimor në të gjitha shkollat e komunës sonë, duke bërë një planifikim dhe një ri sistemim të kuadrit mësimor sipas profileve mësimore në të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli para fillor e deri tek niveli i mesëm i lartë.

Si rezultat i planifikimit të bërë, kemi pasur edhe një konkurs për plotësimin e vendeve të lira në 14 pozicione në shkollat e komunës, shumica e të cilave ishin zëvendësime, pra pozita me kohë të caktuar. Vlen të theksohet fakti se për këto 14 pozita mësimdhënësish dhe edukatorësh, në këtë konkurs kanë aplikuar 123 kandidatë. Drejtoria Komunale e Arsimit ka marrë të gjitha masat që procedura e konkursit të shkojë mirë, duke respektuar të gjitha afatet ligjore dhe udhëzimet administrative të MASHT-it.

Ky konkurs u hap në përputhje të plotë me Udhëzimin më të ri Administrativ 10/2018, i cili hyri në fuqi më 20 korrik 2018. Vlen të theksohet fakti se jemi ndër komunat e vetme, që ky konkurs nuk u anulua nga Inspektorati i Arsimit, sepse në shumë komuna ka ndodhur anulimi i konkurseve, për shkak të faktit se ato komuna nuk kishin hapur konkurse sipas udhëzimit më të ri administrativ, të cilin ne e kemi marrë parasysh sapo ai hyri në fuqi nga Ministria e Arsimit.

Gjatë muajve të verës u mbajtën edhe një varg trajnimesh me arsimtarë e mësimdhënës të fushave të ndryshme kurrikulare, të cilat ishin të nevojshme për ngritjen dhe përgatitjen edhe më të mirë profesionale të mësimdhënësve tanë. Trajnimi i fundit ishte me grupin e Gjuhëve dhe Komunikimit.

Në fund të muajit gusht, nga Ministria e Arsimit kemi pranuar të gjitha librat/tekstet shkollore për klasat 1 deri 9, të cilat fillimisht i kemi vendosur në pikën grumbulluese dhe pastaj ato i kemi shpërndarë në të gjitha shkollat fillore të komunës sonë. Fillimi i Vitit të Ri Shkollor si në mbarë Kosovën, edhe tek ne ishte më 3 Shtator, ditë e hënë, dhe që në fillim, të gjitha SHFMU-të komunës sonë ishin të pajisura me tekste shkollore dhe pajisje të tjera shkollore. Ne kemi qenë dhe do jemi vazhdimisht në kontakt dhe me vizita në shkolla, dhe sipas të gjitha të dhënave që i kemi ne procesi mësimor ka filluar mbarë në të gjitha shkollat e komunës. DKA-ja ka bërë gati një plan me një varg aktiviteteve, dhe fillimisht kemi filluar vizitat dhe takimet me Këshillat e arsimtarëve në të gjitha shkollat. Vizita të këtilla nëpër shkolla nëpër shkolla do të ketë vazhdimisht sepse synojmë që sistemin arsimor të komunës sonë ta ngrisim në një nivel më të lartë, që siguron arsim cilësor.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falënderoj drejtorin e DKA-së që na dha këtë informatë për fillimin e vitit shkollor, por kisha kërkuar nga drejtori që për mbledhje të kuvendit kjo informatë të jetë më e kompletuar, pra të ketë informata shtesë si p.sh: Përgatitjet teknike të objekteve shkollore, pastaj renovimet, lyerjet etj.

Flori Boshnjaku – Kemi nevojë për informatë sepse edhe ne jemi pjesë e kësaj komune, prandaj e falënderoj drejtorin që na ka sjellë këtë informatë. Por ajo që kisha kërkuar nga drejtori i DKA-së nëse ka mundësi që për mbledhje të kuvendit të na bëjë një krahasim me vitin e kaluar, se sa është zvogëluar apo rritur numri i nxënësve në këtë vit, gjithmonë duke e krahasuar me vitin e kaluar. Sa i përket konkurseve e përgëzot drejtorin, dhe më vije mirë që janë duke u zbatuar vendimet, dhe nuk janë duke na u anuluar konkursat. Pastaj sa i përket çështjeve teknike pajtohem që të jenë të përfshira në informatë, të shikohet mos ka ndonjë pengesë, pra është mirë nëse ka mundësi për mbledhje të kuvendit që ta zgjeroni këtë informatë.

Fehmi Cena – Po ashtu edhe unë e përshëndes drejtorin që na ka sjellë këtë informatë, sado e shkurtër që është, por ne kemi nevojë që të informohemi sa më shumë për fillimin e vitit të ri shkollor, uroj që ky vit të shkojë sa më mirë, që të rritet cilësia e cila mendoj se nuk ka qenë shumë në nivel. Desha një sqarim rreth furnizimit të librave për nxënësit nga klasa e 1-9, nga ana e Ministrisë së Arsimit, ajo që më intereson është: A përfshihen të gjitha librat për këtë vit apo vetëm një pjesë e tyre, kurse pjesën tjetër duhet vetë që të blejnë. Për konkurse ju përgëzoj, ne si kuvendar dhe qytetarë një gjë mundemi me e vërejt, se sa është papunësia e madhe sepse për 14 vende kanë konkurruar 123 kandidat, dhe besoj se që të gjithë kanë qenë të kualifikuar, po ashtu besoj se një numër i madh nuk kanë konkurruar fare..

Rasim Fazliu – Falënderoj drejtorin e DKA-së për këtë informatë, e përgëzoj për punën që është duke e bërë sepse janë duke u parë disa lëvizje, disa ndryshime dhe disa takime, e gjitha kjo shkon në angazhimin që të përmirësojë rrjedhën e procesit edukativo arsimor. Gjithmonë po kemi probleme me lëndë djegëse, prandaj desha ta pyes drejtorin se për këtë stinë dimri a i kanë kontraktuar, nëse po kur do të fillojë furnizimi i shkollave me lëndë djegëse.

Avni Morina – Ju falënderoj të gjithëve për kontributin dhe pyetjet e bërë, më parë kam ë shkruar më shumë dhe kam marr kritika, ku më kanë thënë se je duke e quar gjatë, prandaj jam munduar që të i shkruaj në pika sa më të shkurta, por ja ndodhë që mos të jetë informata e plotë dhe mos të përfshihen të gjitha ato aspektet që kanë të bëjnë me fillimin e vitit të ri shkollor. Po ja filloj nga pyetje e fundit që e bëri z. Rasim Fazliu, i nderuar me datë 20 korrik 2018, ministria e arsimit ka marrë vendim që të ndalohet përdorimi i thëngjillit si lëndë djegëse nëpër shkolla, ne këtë informatë e kemi transmetuar tek të gjithë drejtorët e shkollave të komunë sonë, ku menjëherë kam kërkuar nga zyra e prokurimit që të ndalojë procedurat e prokurimit që kanë qenë për thëngjill. Gatio gjysma e shkollave të komunës sonë përdorin thëngjillin si lëndë djegëse, tani ato mjete që kanë qenë të paraparë për thëngjill, do të shkojnë për lëndë tjera djegëse. I kam dërguar Ministrisë së Arsimit numrin e shkollave që kanë përdorur deri më tani thëngjillin si lëndë djegëse, po ashtu sasinë se sa kanë përdorur. Ne do ta zbatojmë këtë vendim të ministrisë, por duhet ta dini se kjo do të jetë një ngarkesë për buxhetin e komunës, dhe me siguri që do të ketë mjete shtesë për furnizim. Z. Fehmi Cena pyeti sa i përket furnizimit me libra, i nderuar ato libra që kanë qenë të botuara nga Ministria e Arsimit, kurse të autorizuar për shpërndarje kanë qenë dy kompani, Libri Shkollor dhe Dukagjini. Sasia e librave ka qenë e mjaftueshme, por disa tekste të gjuhëve të huaja të disa klasave nuk kanë qenë në botim dhe do ti vinë më vonë. Kurse i gjithë kontingjenti i librave që na ka ardhur është shpërndarë në përputhje me specifikacionet e shkollave, ku çdo shkollë na ka dërguar listën me numrin e nxënësve nga klasa e 1-9, dhe shpërndarja ka ndodhur në kohë rekorde. E nderuara znj. Florije Boshnjaku është me të vërtetë shqetësuese zvogëlimi i numrit të nxënësve në shkolla, për këtë vit ende nuk i kemi informacionet e para të sakta, por shumë shpejtë do i marrë edhe informacionet e sakta se sa është zvogëluar numri i nxënësve, por e di që në nivel komune numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme sillet diku rreth 600 nxënës më pak se vitin e kaluar. Sa i përket përgatitjeve teknike të objekteve shkollore që pyeti e nderuara znj. Floroda Bajraktari, ne këtë vit kemi pasur vonesa në procedurat e prokurimit sepse tenderi që ka qenë për lyerje dhe për meremetim të shkollave është vonuar bukur shumë, dhe nga kjo kanë rrjedhë pasojat dhe në disa shkolla nuk kemi mundur që të intervenojmë me kohë. Në disa shkolla të tjera kam marr informata se disa drejtorë edhe me vetë iniciativë e kanë bërë lyerjen e objekteve të shkollave, drejtori i shkollës fillore të Gurit të Kuq e ka bërë lyerjen e komplet shkollës, madje e ka lyer edhe pjesën e jashtme të shkollës. Sa i përket plotësimit të informatës për mbledhje të kuvendit, këtë do e keni për kuvend, siç ju thash edhe në fillim unë jam në proces të marrjes së informatave nga shkollat e komunës së Rahovecit, do mundohem gjë gjithë vitin të jam prezentë nëpër shkollat e komunë, sepse e kam vërejtur se prezenca ime i mbanë drejtorët e shkollave në thonjëza në presion.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e bërë, po ashtu falënderoj drejtorin e DKA-së, për këtë informatë që na ka sjellë. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i Propozim Buxhetit si dhe KAB-it për vitin 2019 – 2021.

Për këtë pikë të rendit të ditës e ftojë Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi, pasi siç e dini të gjithë Drejtoi për Buxhet Financa dhe z. Afrim Limani ka pasur një aksident.

Përparim Krasniqi – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, për shkak të mungesës së drejtorit për buxhet dhe financa do ju prezantoj në vija të trasha buxhetin për vitin 2019. Por sipas informatës që e kam në mbledhjen të kuvendit drejtori z. Afrim Limani, ka shpreh dëshirë që të jetë prezent në mbledhje, ku do ju jepe të gjitha përgjigjet e nevojshme sa i përket buxhetit për vitin 2019. Mbas qarkores së parë dhe të dytë të buxhetit për komunën e Rahovecit, buxheti në total është diku rreth 13,658,892.00, do flasë vetëm ajo që është zyrtare, grandit i përgjithshëm është 5,231,296,00 €, fondit i shëndetësisë është 1,686,240.00 €, grandit i arsimit është 5,380,480.00 €, huamarrje në arsim për herë të parë është duke u bërë ku shuma është prej 33,719.00 €, fondit për këshillin e Hoçës së Madhe është 23,494.00 €, huamarrje në shëndetësi është 134,899.00 €, të hyrat vetanake

të planifikuara për vitin 2019, janë 1,168,757.00 €. Po ashtu në tabelar kemi listën e projekteve kapitale, duke e falënderuar OSBE-në për organizimin që e kemi pasur me anëtarë të KPF-së dhe disa drejtorë në Prevallë, ne si ekzekutiv i kemi dhënë disa sqarime të cilat kanë qenë të nevojshme, po ashtu kemi pasur disa vërejtje, u është dashur të ndërhyjnë në disa kode të drejtorisë së arsimit, sepse kanë qenë kode të përgjithshme. Ne tani e kemi ndryshuar materialin, po ashtu në këtë tubim është kërkuar sqarim shtesë për disa kode që janë të përgjithshme dhe që figurojnë në listën e projekteve kapitale, ne i kemi mbledhur kërkesat e nevojshme dhe nëse ka nevojë për informata shtesë ne jemi aty. Kaq për fillim, nëse keni ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim jemi këtu për të ju përgjigjur.

Rasim Fazliu – Është e vërtetë që kemi pasur një takim me anëtarët e KPF-së për këtë temë që jemi sot duke e diskutuar, por të ju them të drejtën jam shumë i zhgënjyer me atë takim, prej sa janë duke u mbajtur këto takime kur më të dobëta nuk ka pasur se atë ditë, kjo nuk ka qenë me fajin e kryesuesit dhe neve si anëtar të KPF-së, por organizatorët në këtë rast OSBE-ja ka qenë në nivelin shumë të dobët. Në vitet e kaluara organizatori OSBE-ja në kanë ofruar udhëzime dhe rekomandime, ku na kanë ndihmuar neve anëtarëve të KPF-së, në mënyrë që të bëjmë një buxhet sa më praktik dhe sa më të mirë për qytetarët e komunës së Rahovecit. Kurse atë ditë ata sikurse të jenë pjesë e politikës, vetëm thanë se jemi të ngazëllyer sepse ju si KPF i keni mbajtur të gjitha dëgjimet buxhetore, nuk e di qsa ka pasur kjo për tu habitur, ne gjithmonë secilin vit këto tubime i kemi mbajtur. Kjo pra është një vërejtje për organizatorët, besoj se viteve tjera do të bëjnë organizim pak më të mirë. Sa i përket buxhetit, falënderoj drejtorin që i ka bërë korrigjimet e atyre vërejtjeve të vogla që i kemi dhënë ne në këtë takim, por një gjë për mua që është shumë jetike dhe është shumë mirë që të ndodhë është se për mbledhjen e kuvendit kisha propozuar që të gjithë drejtorët që marrin pjesë tek kjo kornizë buxhetore, të i specifikojnë të gjitha kodet me emra, pra se cila rrugë ose shkollë do ndërtohet, dhe mos të i lënë si kode të përgjithshme. Nëse nuk e lejon sistemi në buxhet të i specifikoni, atëherë ne si kuvendar duhet që të kemi material shtesë para se të votohet buxheti me këto kode të specifikuara, po ja nisi me një shembull konkret, nëse thuhet në buxhet meremetimi i rrugëve fushore në komunën e Rahovecit, në sistem edhe ne jemi të pajtimit që të qëndroj kështu pasi nuk ka mundësi që të ndryshohet, por ne kuvendarët duhet që të kemi në material, se do të ndërtohet rruga në këtë fshat, në këtë lagje etj. Pra aq sa ka buxhet por të dihen rrugët me emër dhe mbiemër se ku do të ndërtohen. Ne si kuvendarë të zgjedhur para qytetarëve duhet që të japim pastaj përgjegjësi para qytetarëve, por edhe ekzekutivi të ketë në llogaridhënie, pra qëllimi imë është që të jemi më konkret dhe të dimë se ku do të punohet, sepse nëse mua nesër më ndalë një qytetar i komunë dhe më pyet se çka do të bëhet këtu, unë si përfaqësues i tyre nuk bënë që mos të i di detajet se çka do të ndërtohet aty. I nderuari drejtor po ashtu kishte me qenë mirë të shkojë kështu: Projektet e reja i ke cekë, projektet që janë në vazhdim i ke cekë po ashtu, unë kam një kërkesë shtesë, të na specifikohet se cilat projekte janë të përfunduara tërësisht, por vetëm na ka mbetur që ti paguajmë mjetet, pastaj një projekt që ka pasur të kryhet për 3 vite është kryer ndoshta për një vit, sepse operatori ka pasur mjete dhe i ka kryer, pra këso informata për kuvend duhesh që të na sjellësh. Për më shumë sa i përket buxhetit do të diskutoj në mbledhje të kuvendit.

Përparim Krasniqi – Tek meremetimi i rrugëve fushore të nderuar kuvendarë, ne e kemi listën prej 48 kërkesave që na janë adresuar nga të gjitha fshatrat dhe qyteti, janë të cekura edhe gjatësitë e rrugëve, pra ne shënimet i kemi të gjitha të sakta. Nëse ka nevojë që të prezantojmë edhe këtë ne e bëjmë, por dua ta dini se është një material tepër voluminoz, por ne jemi të gatshëm që të ju njoftojmë për të gjitha projektet.

Rasim Fazliu – Shumë mirë që i keni ju të gjitha këto kërkesa, por i nderuar ju të gjitha 48 rrugë nuk mundeni të i shtroni me zhavorr, prandaj unë kërkoj nga ti që për mbledhje të kuvendit, e na thënë, se nga 48 rrugë që na kanë ardhur kërkesa, katër rrugë do të mbushen dhe ato janë kjo dhe kjo, kaq kërkojmë ne nga ju, asgjë më tepër.

Përparim Krasniqi – Ne si drejtori i kemi të evidentuar mbi 100 rrugë lokale, ku i kemi bërë matjet e të gjitha rrugëve, vlera e tyre është rreth 1,140,000.00 €, por ne nuk kemi buxhet që të gjitha këto rrugë të i rregullojmë. Në këtë vit dhe vitin e ardhshëm aq sa kemi buxhet dhe mundësi dhe sa në lejon kodi, do të shikojmë që ti rregullojmë rrugët me prioritet, pra nga të gjitha vendbanimet do ti zgjedhim nga një ose dy rrugë që janë më me prioritet, ne i kemi të listuar të gjitha në listë si rrugë, kanalizimet etj.

Florida Bajraktari – Tek planifikimi i investimeve kapitale për vitin 2019 – 2021, e keni cekur tek kodi ndërtimi dhe përmirësimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit – vazhdim, pastaj është cekur një kod i ri përmirësimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit. Pse i keni cekur dy kode, nëse ceket njëri si vazhdim nuk është dashur të jenë dy kode, por të përfshihen të gjitha në një kodë. Po ashtu tek kodi i ri krijimi i parkingjeve të reja në qytet, pyetje ime është: Ku do të krijohen këto parkingje, pasi që e dimë se qyteti i Rahovecit nuk ka hapësira të mjaftueshme për parkingje publike.

Përparim Krasniqi – Përmirësimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit, është një kontratë e trashëguar nga viti 2016 dhe cila është duke vazhduar ende, ne me mjetet që i kemi në dispozicion duhet që ta mbyllim në vitin 2019. Ndërsa pjesa tjetër e cila është intervenime në kanalizime, në kuvend e kemi nxjerrë një kod, në bazë të kërkesave të qytetarëve sepse kemi parë që ka kërkesa të shumta për kanalizime, pra ky kod do i mbulojë të gjitha kërkesat që na kanë ardhur, pra janë dy kode nuk është kodi i njëjtë. Sa i përket parkingjeve ne e kemi një projekt të cilin do të hedhim në qytet si ide, ku do të shikojmë mundësinë që ta zgjerojmë rrugën Xhella Hajda – Toni, ku do të bëhen disa parkingje zik-zake, pra do të bëhet një lloj analize, ku do të kemi edhe dëgjime publike me qytetar ku do i mirëpresim idetë e qytetarëve.

Florije Boshnjaku – I nderuari drejtor tek KAB-i, në faqe nr.6 tek drejtorja për shëndetësi: Propozoj që në fund të shtohet edhe ofrimi i shërbimeve sociale për të gjitha qytetoret e komunës së Rahovecit, sepse kjo drejtori e ka edhe shëndetësinë edhe shërbime sociale, besoj se kjo duhet të përfshihet. Sa i përket projekteve ne kemi diskutuar edhe atë ditë, por i nderuar tek drejtorja për ekonomi e cila e ka projektin ndërtimi i shtëpisë së pleqve, ne jemi të pajtimit që kjo të ndërtohet, por kishte me qenë mirë që ta përmirësoni dhe ta cekni ndërtimi i shtëpisë së pleqve për qëndrim ditor, është mirë që për kuvend të jetë kjo e përmirësuar sepse është një projekt me vend. Sa i përket shqetësimeve të kolegëve plotësisht edhe unë pajtohem, por të nderuar edhe ju kur keni qenë në pushtet por edhe tani kërkoj që të ketë emërtime se cilat rrugë do të shtrohen, në bazë të përvojës nëse ne kërkojmë që vetëm kjo rrugë të ndërtohet, por nëse ajo rrugë ka pengesa, ti më nuk mundesh të thirrësh në këtë kod, për këtë është shumë me rëndësi. Pra nëse specifikohet dhe kërkon donacione për këtë kod, por ka probleme atëherë ti nuk mundesh më të kërkojë, por nëse është kod i përgjithshëm atëherë mundesh të kërkojë edhe donacione nga jashtë por edhe nga ministritë përkatëse për të ndërtuar rrugë.

Përparim Krasniqi – Ju faleminderit për kontributin e dhënë znj. Florije Boshnjaku, ne në kuadër të drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, kemi planifikuar dy projekte të reja, projekte me bashkëfinancim për rastet sociale, dhe ofrimi i shërbimeve sociale përfshihet në këtë projekt.

Florije Boshnjaku – I nderuar unë kërkoj që ofrimi i shërbimeve sociale për të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit të përfshihet, sepse e kemi obligim me ligj. Është bërë një lëshim dhe është mirë që të përmirësohet.

Dervish Çadraku – Të nderuar unë prapë insistoj se ne duhet që të kemi një pasqyrë reale me emër dhe mbiemër të rrugëve të cilat do të përfshihen në projektet e ndryshme, pra në një farë mënyrë e them që të kemi si pasaportë në xhep, në mënyrë që çdo qytetar që na pyet në rrugë ne të dimë se për çka jemi këtu. E kuptoj po ashtu që e thatë se kodi nuk mundet të ndryshohet, nuk jam duke kërkuar që të ceket këtu, por të na shpërndahet neve jashtë këtij materiali, dhe nëse ka pengesa tek ndonjë rrugë atëherë qytetari do ta ketë informatën pse është ajo pengesë, faji nuk është tek ne që nuk e kemi përfshirë në projekt, por problemi qëndron diku tjetër. Sa i takon pikave të tjera, i kam disa pyetje për drejtorin, tek kodi 89742, kodi i ri, konsulenc për hartim e projekteve për fermer, janë të ndara diku rreth 30,000.00 €. Pyetje ime është çka nënkupton kjo dhe çka do të harxhohen këto 30,000.00 €. Pastaj kodi 46534, pajisje për teknologji informative, kodi i ri, pastaj vjen kodi tjetër pajisje për IT, laborator dhe mjete konkretizimi, pastaj prapë disa herë përsëritet pajisje për IT, laborator dhe mjete konkretizimi, vetëm në një kodë është shtuar edhe kamera, të gjitha këto kode të reja por me përmbajtje të njëjtë, pyetje ime është pse janë bërë këto kode.

Përparim Krasniqi – Sa i përket rrugëve dhe rrugicave po ju japë edhe një herë edhe një sqarim. Ne si drejtori mbas kërkesave që na janë adresuar, ne kemi formuar një ekip nga inxhinierët ku kemi dalë dhe i kemi evidentuar të gjitha rrugët. Po ju cekim disa rrugë nga vendbanimi i z. Dervish çardaku, i kemi evidentuar 3 rrugë që janë goxha të gjata, p.sh ndërtimi i rrugës Kosova e re, pastaj ndërtimi i rrugës Ali Shabani dhe ndërtimi i rrugës shpëtim çardaku. Ne këto rrugë i kemi të adresuara, por nëse ne mendoni se duhet që ti fusim këto rrugë

në projekt buxhetor dhe të gjitha rrugët që do i ndërtojmë, do na dele një vlerë shumë e madhe, dhe nuk kemi mundësi me bë investimin brenda vitit. Ajo që ne bëjmë është se do ti përzgjedhim rrugët që janë me prioritet, së pari shikojmë se a ka ajo rrugë infrastrukturën nëntokësore, pra ne tani i kemi të gjitha informatat, pra e kemi një pasqyrë të këtyre rrugëve, por nëse ju dëshironi listën e të gjitha rrugëve dhe rrugicave, atëherë ne jemi në dispozicion që të ju ofrojmë këtë listë. Sa i përket konsulencës për fermer, ne e kemi në plan që vitin e ardhshëm me e hapë një zyrë në kuadër të drejtorisë për bujqësi, ku do të ofrohen materiale, kushte dhe informata, fermerëve që aplikojnë për grande qeveritare, për arsye se ka raste që aplikantët të cilët kanë aplikuar nëpër ministri, ka ndodhur që për një gabim të vogël nuk kanë fituar grandin, për arsye se nuk kanë ditur që ta plotësojnë formularin. Ne do të ftojmë disa ekspertë të kësaj fushe, ku do ti rregullojnë të gjitha këto aplikacione për fermerët tanë. Po ju informoj se në këtë vite asnjë qytetar nga komuna jonë nuk ka fituar ndonjë grand nga ministria e bujqësisë, për arsye të këtyre pengesave. Sa i përket pajisjeve për teknologji informative, sa e di unë MASHT-i ka kërkuar nga DKA-ja. Që të bëjnë një marrëveshje për investim në këto shkolla, pra janë kode të cilat i ka kërkuar ministria, por për ma saktë besoj se do ju sqaroj drejtori kur të vije.

Fehmi Cena – Mendoj se vërehet mungesa që nuk është drejtori i financave në mbledhje, mendoj se ai do na kishte dhënë më shumë informata, ne kemi vërejtjet tona dhe sugjerimet tona, por natyrisht që në këtë mbledhje nuk kemi mundësi që ti kryejmë të gjitha, disa do i lëmë edhe për mbledhje të kuvendit. Do vazhdoj nga faqja e parë ku do kërkoj disa sqarime, përndryshe ne si KPF kemi marrë pjesë edhe në dëgjime publike, ku i kemi dëgjuar hallet dhe nevojat e qytetarëve për së afërmi, mundem të them se shumica e kërkesave të tyre janë të përfshira në këtë projekt buxhet, ku të ketë buxhet më tepër komuna që të mundet me i realizua të gjitha kërkesat brenda një viti ose tre viteve, por kjo është e pamundur sepse kërkesat janë të shumta, kurse buxheti është i kufizuar, kërkesa e jonë është që të shkohet gjithmonë sipas prioriteteve. Tek infrastrukturë do të ndalesha tek çështja e lumit të Dullos në Rahovec, ky lumë përmendet në dy raste në një rast përmendet kolektori, pyetje ime është për çfarë kolektori është fjala, dhe ajo që më intereson është se si e ka gjendjen shtrati i lumit Dullo, thuhet se kanalizimi është i ndarë, por sa e di unë vetëm në një pjesë, por pyetje ime është ku është i ndarë, sepse gjatë verës aty vije erë e kanalizimit në këtë lumë. E di që është projekt i kushtueshëm por mendoj se lumi dullo duhet patjetër të jetë i pastër, mendoj se për tre vite kishte me qenë mirë që komplet ky lumë të pastrohet nga kanalizimet. Pastaj përmendet tregu i gjelbër ditor, kjo me siguri është për qytet, çka mendoni të bëni me këtë treg, ne e kemi një pjesë ku e kemi ndërtuar tregun, por aty nuk bëhet tregu, por si gjithmonë në rrugë. Pyetja ime është a mendoni të investoni diçka shtesë në këtë treg, apo vetëm që shitësit të kalojnë në këto tezka që deri më tani nuk janë duke u përdorur. Sa i përket shëndetësisë, së pari është një radhitje ku ceket, ndërtimi i shtëpive dhe ndihmë me material ndërtimor për familje në nevojë, kjo duhet që të jetë në kompetencë të shërbimeve sociale. Objekti i QKMF-së i cili është duke u ndërtuar parashihet që të ndërtohet për 3 vite, pyetje ime është a do të kryhet përfundimisht deri në atë kohë, dhe a i duhen të gjitha këto mjete që i keni ndarë dhe gjithë kjo kohë, pasi që ky objekt është ndërtuar deri në kulm. E kam bërë edhe një pyetje kur ishim në Prevallë sa i përket qendrës së shëndetit mendor bazuar në bashkësi, sipas ligjit komuna ka të drejtë të bëjë këtë, sepse të sëmurit mental në komunën tonë është goxha një numër i madh, në këtë qendër është e paraparë qëndrimi ditor i tyre dhe mjekimi. Sepse kemi probleme kur vinë tek ne që të mjekohen, një pjesë të terapisë ata e kanë kryer në regionin e Gjakovës, kurse Gjakova nga viti i kaluar e ka kaluar kujdesin tek ne në QKMF, pra do të ishte mirë që kujdesi i tyre të finalizohet pikërisht me një objekt të veçantë mjekësor i cili quhet qendra e shëndetit mendor bazuar në bashkësi, ku do të punësohen mjeku dhe psikologu, dhe aty do të trajtohen ata, mendoj se brenda këtyre 3 viteve komuna e Rahovecit duhet të ketë një shërbim të tillë. Riparimi i monumenteve historike të trashëgimisë kulturore, për këtë kam vërejtje sa i përket buxhetit që e keni ndarë, e kam përmendur edhe më parë në Rahovec janë disa shtëpi të cilat konsiderojmë se kanë rëndësi të trashëgimisë kulturore, këto shtëpi kërkojnë renovim sepse ata janë në shkatërrim e sipër pra nëse kalojnë edhe tre vite dhe ne nuk kujdesemi për ta, atëherë nga ta nuk do të mbesë asgjë, mendoj se nëse mendojmë se Rahoveci duhet që të zhvillojë turizmin atëherë këto objekte kanë rëndësi, prandaj mendoj se duhet që të ketë më shumë buxhet se sa 15-20 mijë euro brenda vitit. Parashihen disa ndërtime të shkollave, pak a shumë e di gjendjen në teren, këtu e keni cekur ndërtimi i shkollës në Kaznik, a është ndërtimi apo renovimi i shkollës, në

këto shkolla numri i nxënësve po bije. Ne kemi pasur bisedë edhe më herë që mos të orientohejmë shumë në ndërtimin e objekteve të shkollës, por këto ekzistuese kishte me qenë mirë që ti rinovojmë, u përmend diku nxehje qendrore ku ishte një investim shumë i vogël, nuk e di a janë të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit me nxehje qendrore që nuk e keni paraparë më shumë buxhet, të nderuar duhet që secila shkollë të ketë nxehje qendrore, dhe brenda tre viteve mirë kishte me qenë që të kenë të gjitha shkollat.

Përparim Krasniqi – Do të ndalem tek disa çështje që i diskutuat doktor, sa i përket kërkesave të qytetarëve, ne dimë se duke ju falënderuar juve si KPF të cilët keni bashkëpunuar me ne si ekzekutiv dhe të gjitha ato kërkesa kanë hyrë në buxhetin për vitin 2019. Buxheti është 4,203,000.00 € dhe nga kjo nuk kemi mundësi që të ikim as për një cent, pra gjithçka është e limituar, por mendoj se shumica e kërkesave të qytetarëve janë përfshirë në planifikim të buxhetit për vitin 2019. Sa i përket lumit Dullo, në shumicën e kanalizimeve ku kemi mundur që të ndërhyjmë, si në vendbanime e kemi realizuar, pra nuk derdhen në lum, por ka pjesë tjera në qytet ku nuk mundemi me ndërhy që me i nda ujërat e zeza prej ujërave atmosferik. Mendoj se pjesa ku do të vazhdoj kolektori është pjesa poshtë tek ura, dhe do të vazhdohet më poshtë sepse derdhet janë duke u bërë në vendbanime, pra është paraparë që kolektori të jetë edhe jashtë vendbanimit. Sa i përket tregut të gjelbër, ne kemi menduar se pjesa ku gjendet për momentin ky treg është vendi i ngushtë, dhe kishte me qenë më mirë mendojmë që ti prekim pak edhe pjesët periferike të qytetit, sepse ka nevojë edhe për parkingje. Ne jemi duke menduar me e gjete një hapësirë të re jashtë qytetit, ku do të ndërtojmë një treg modern, dhe ky projekt është planifikuar që të bëhet në vitin e ardhshëm. Kurse sa i përket QKMF-së ne këtë vite do ja fillojmë me fazën e dytë të meremetimit dhe rregullimit të tërësishëm të saj, kemi premtim nga Ministria e Financave se do ta mbështesë këtë projekt, po ashtu kemi premtime edhe nga zyra e kryeministrit, dhe besoj se në vitin 2019 do të bëhet realizimi i këtij projekti në tërësi. Kurse meremetimi dhe renovimi i shtëpive të vjetra, besoj se drejtorja e kulturës e ka një komision, ku janë duke i evidentuar disa shtëpi të vjetra dhe disa monumente historike, dhe besoj se kur të dalin me një raport do të shohim se sa kanë mundësi dhe buxhet që ti realizojnë, e dimë se buxheti është shumë pak që të realizohen të gjitha ato monumente historike, por ajo që e di është se do të fillohet që të bëhet në këtë drejtim.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e zhvilluar, e qes në votim Propozim Buxhetin si dhe KAB-in për vitin 2019 – 2021: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5), e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

6. Të ndryshme.

Kryesuesi – Nëse nuk ka askush të diskutoj rreth pikës së fundit të rendit të ditës, atëherë të nderuar anëtar të KPF-së ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 11:35

Procesmbajtësi

Skender Hamza

